



100% SHIJE
STEVIAS
0% SHEQER
0% KALORI

ZGJIDH
ANËN
"GREEN"
TË
COLA

Fillimi > -Kronikë

Operacioni “Divjaka”/ 4 të arrestuar, mes tyre një punonjës policie. Si u kapën me kokainë në lokal, në shtëpi iu gjenden 3 armë gjahu pa leje

24 Prill, 2020 10:24 |



Madhësia e tekstit: - +

Policia e Fierit në bashkëpunim me Prokurorinë e Lushnjës kanë finalizuar një operacion duke arrestuar 4 persona të cilët janë kapur me një sasi kokaine dhe u janë gjetur 3 armë gjahu.



Seksioni për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve në DVP Fier, në bashkëpunim me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, pas informacioneve të marra në rrugë operative dhe me kryerjen e veprimeve të shpejta procedurale, nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit, kanë bërë të mundur finalizimin e operacionit policor “Divjaka”, në përfundim të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

A. Sh., 43 vjeç, banues në Divjakë;

L. B., 53 vjeç, banues në Divjakë;

H. M., 46 vjeç, banues në Tiranë;

I. V., 38 vjeç, banues në Tiranë (me detyrë punonjës policie)

Gjatë operacionit, në hyrje të qytetit të Divjakës, në lokalin e shtetasit

L. B, u kapën në kushtet e flagrancës, me një sasi prej 34 gr. lëndë narkotike të dyshuar kokainë, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Gjithashtu, nga kontrollet e banesave të tyre dhe më konkretisht në banesën e shtetasit A. Sh, në Divjakë, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 3 armë gjahu pa leje, 2 pajisje për prodhimin e fishekëve, si dhe një sasi baruti për prodhimin e fishekëve të gjuetisë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, në ngarkim të shtetasit A. Sh., për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhim dhe mbajtja pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, në ngarkim të shtetasit L. B., për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe në ngarkim të shtetasve H. M. dhe I. V., për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Për t'u bërë pjesë e grupit “Balkanweb” mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Divjaka kokaine polic

TË NGJASHME



FOTO/ Qarkullonte me armë dhe kokainë, pranga 39- vjeçarit në Tepelenë, mbante embleme policie për t'iu shmangur kontrolleve

01 Maj, 2020



Sekuestronet makina me kokainë dhe armë në Memaliaj, arrestohen shoferi dhe pronari i saj

01 Maj, 2020


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



“Jemi të gjunjëzuar”, Shoqata e Bareve dhe Clubeve letër Edi Ramës: Duam të rihapemi sa më parë dhe pa kufizim orar!

02 Maj, 2020




Aksident në aksin Librazhd-Përrenjas, kamioni me targa të huaja përplaslet me urën hekurudhore

02 Maj, 2020



“Jemi policia”, si e organizoi planin e grabitjes i riu në banesën e ish-krushkut. Detajet nga ngjarja në Zall Herr

02 Maj, 2020



“Grabitja shkaktoi tronditje”, Lleshaj: Autorët duhet të paguajnë jo vetëm detyrimin përballë ligjit, por edhe...

02 Maj, 2020



Zbulohen fotot, nxirje dhe plagë në trupin e terroristit nga Tashikistani! U dhunua nga regjimi apo në luftën e ISIS?

02 Maj, 2020



“E kanë dhunuar me rrymë elektrike, tani po i terrorizojnë familjen”, avokati i terroristit: Mos e çoni në Tashikistan, ja pse erdhi në Shqipëri

02 Maj, 2020

KATEGORIA VIDEO



Rubrika gazmore/Kush thyen rregullat në kuvend, çfarë e shqetëson deputetin Gjuzi

02 Maj, 2020



“Ishte shumë e rëndë, tmerrohem kur e kujtoj”! Pacientja tek infektivë rrëfen vështirësitë e COVID, Manastirliu: U rikthye në jetë, pasi pa vdekjen me sy!

02 Maj, 2020




(Video) “Mos e bëj dhe ti si Ramiz Alia që erdhi e na gënjeu”, Rama inspekton aksin Gusmar– Kuc, që lidh Tepelenën me Himarën

02 Maj, 2020




“Kam një pikturë që quhet Fatos ‘Lubonja në alterego’, rrëfimet e Moza Ahmetit: Tregimi për Nexhmije Hoxhën që i censuroi poezinë për të dashurin

Fatmira Nikolli | 02 Maj, 2020



Luana Vjollca fiton çmim në SHBA, “Golden Panther Awards” nderon këngëtaresh shqiptare (Video)

02 Maj, 2020



Hështori e trishëritë që vjen nga Fieri/ Nëna nxjerr shëtitje vajzën e saj të sëmurë, mesazhi i fortë përmes trëndafillave: Rrini në shtëpi për veten dhe Ertëni (VIDEO)



Ervis Kuçi | 02 Maj, 2020




Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Kerko ketu



LAJMET E FUNDIT




Mjeku Tritan Kalo i përgjigjet ironisë së Ilir Beqajt: E gjej kohën të informoj publikun që vuan pusht-shtetarët e pangopur

02 Maj, 2020



“Liria e medias në Shqipëri ka pësuar rënie”, Zëri i Amerikës: Krizat e njëpasnjëshme kanë dëmtuar gazetaret

02 Maj, 2020



Dokumenti/ FSHF “klonon” modelin gjerman për rifillimin e aktivitetit! Ja çfarë parashikohet në draftin e protokollit sanitar

02 Maj, 2020




Quajini rebelët e Francës! Lioni udhëheq grupin e të pakënaqurve: gati padia ndaj ligës së futbollit

02 Maj, 2020



Konfirmohen 10 raste të reja me koronavirus në Kosovë

02 Maj, 2020



“Kemi respektuar me rigorozitet rregullat”, rrëfhet Helena Kadare: Nuk është punë frike, duhet të mendojmë për të tjerët, të mos bëhemi rrezik

02 Maj, 2020



HYSENBELLIU GROUP

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

